

Në bazë të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), të nenit 41 të Ligjit nr. 2004/37, për ndërtim dhe të nenit 33, pika 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të datës 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2010, miratoi

**RR E G U L L O R E N**  
**PËR**  
**SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË PRONËS KOMUNALE**  
**PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHËSHME**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për ndërtimin - vendosjen e objekteve në pronën komunale, në të cilën Komuna e ka të drejtën e pronësisë.

**Neni 2**

2.1 Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- a) lokalet e përkohshme (objektet për kryerjen e veprimtarive sipas nomenklaturës së organizatave biznesore);
- b) qoshqet (shitja e gazetave, revistave, duhanit, librave, lotarive, bizhuterive, suvenireve, luleve, bukës dhe brumërave);
- c) garazhet dhe
- d) kampshtëpizat.

2.2 Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen edhe:

- a) foltoret telefonike,
- b) panot dhe tabelat reklamuese,
- c) ekranet elektronike reklamuese,
- d) rrethojat e përkohshme,
- e) strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve,
- f) gjeneratorët statikë dhe
- g) lojërat në autoparqe.

2.3 Objektet e përkohshme lëvizëse apo sezonale, në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- a) tavolinat para lokaleve dhe shitoreve;
- b) pajisjet për shitjen e akulloreve;
- c) pajisjet për shitjen e pofkave, misrit, gështenjave dhe të ngjashme;
- d) tavolinat lëvizëse për shitjen e lotarive, kartolinave, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bizhuterive, lojërave të fatit e të ngjashme;
- e) automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë;
- f) tendat e hapura lëvizëse me mekanizëm dhe ato montuese për sezonin prill - shtator;
- g) shtatorët për "ringishpil" dhe "lunapark" dhe
- h) objektet e ngjashme lëvizëse apo sezonale.

## 2.4 Antenat satelitore dhe shpërndarëse.

### **Neni 3**

Sipërfaqe publike në kuptim të kësaj Rregulloreje, është toka në të cilën Komuna e ka të drejtën e administrimit dhe është e destinuar si sipërfaqe publike për nevojat publike dhe të interesit të përgjithshëm shoqëror.

### **Neni 4**

4.1 Objektet e përkohshme nga neni 2 i kësaj Rregulloreje, mund të vendosen në pronësi komunale, deri sa të mos realizohet Plani rregullues.

4.2 Objektet nga neni 2, paragrafi 1, pika 1 dhe 2 e kësaj Rregulloreje, mund të vendosen në pronën komunale ku Plani rregullues nuk realizohet brenda afatit 5 - vjeçar.

### **Neni 5**

5.1 Sipërfaqja bruto e objekteve të përkohshme nga neni 2, parag. 1 i kësaj Rregulloreje, nuk mund të jetë më e madhe se 30 m<sup>2</sup>.

5.2 Sipërfaqja e objekteve të përkohshme nga neni 2, parag. 2 i kësaj Rregulloreje, nuk mund të jetë më e madhe se 6 m<sup>2</sup>.

5.3 Sipërfaqja e garazhit në kuptim të kësaj Rregulloreje, nuk mund të jetë më e madhe se 18 m<sup>2</sup>.

### **Neni 6**

6.1 Ndërtimi - vendosja e objekteve të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, duhet të bëhet vetëm me material të lehtë ndërtimor (druri, plastike apo të kombinuar nga këto dy materiale), me kusht që të sigurohet stabiliteti i objektit dhe siguria e personave.

6.2 Nga pika 1 e këtij neni, objektet e përkohshme mund të ndërtohen edhe me material tjetër ndërtimor, por pa pllakë dhe mure nga betoni i armuar dhe nëse ky ndërtim parashihet me planin për vendosjen e objekteve të përkohshme të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

## **Neni 7**

7.1 Plani i ndërtimit - vendosjes së objekteve të përkohshme nga neni 2, pikat 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, miratohet nga Kuvendi i Komunës, me propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

7.2 Me planin nga pika 1 të këtij neni, caktohen lokacionet e sakta të tokës ndërtimore, në të cilat mund të vendosen objektet e përkohshme.

7.3 Llojin e veprimtarisë që duhet ushtruar në lokalet e përkohshme, në kuptim të kësaj Rregulloreje, e cakton Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit.

## **Neni 8**

8.1 Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, jep leje për shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm.

8.2 Vendimi nga pika 1 e këtij neni, përpos elementeve formale juridike, përmban:

- a) të dhënat urbanistike të tokës dhe kushtet urbanistiko - teknike të llojit të objektit të përkohshëm që duhet ndërtuar-vendosur;
- b) shenjën kadastrore dhe sipërfaqen e tokës së dhënë në shfrytëzim dhe
- c) obligimin ligjor për pagimin e kompensimit - taksave për shfrytëzimin e tokës dhe afatet e pagesës.

8.3 Në vendimin për dhënien e lejes për shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm, është e domosdoshme të konstatohet edhe fakti se shpenzimet e largimit të objektit të përkohshëm, në rastet e parapara me këtë Rregullore, në çdo rast, i mbulon pronari i objektit të përkohshëm, si dhe obligimin për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme.

## **Neni 9**

9.1 Nëse nuk bëhet realizimi i planit rregullues paraprak për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm edhe pas kalimit të afatit të caktuar me vendim, sipas kësaj Rregulloreje, e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore mund të vazhdohet.

9.2 Të drejtën për vazhdimin e shfrytëzimit të përkohshëm e bën organi që ka nxjerr vendimin paraprak.

9.3 Vazhdimi i së drejtës për shfrytëzim, nga pika 1 dhe 2 e këtij neni, bëhet me vendim të veçantë.

## **Neni 10**

10.1 Lartësia e kompensimit për shfrytëzim bëhet sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

10.2 Planin për rregullimin e hapësirave për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën komunale, e harton Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

10.3 Planin nga pika 1 e këtij neni, e miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

## **Neni 11**

Me Planin për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme, pos tjerash duhet respektuar edhe këto kritere:

- a) që të vendosen në pronën komunale, në të cilën Komuna e ka të drejtën e administrimit;
- b) që prona të mos ketë destinim të caktuar me plan urbanistik, apo realizimi i planit të caktuar urbanistik nuk do të bëhet brenda afatit 5-vjeçar;
- c) që me ndërtimin - vendosjen e përkohshme të objektit, nuk do të bëhet zënia e sipërfaqes së trotuarit, apo pengesa e objekteve dhe shtëpive tjera;
- d) që në udhëkryqe dhe kënde të rrugëve, të mos zvogëlohet pamja dhe të mos rrezikohet siguria në komunikacion;
- e) që të mos pengohet vlera ambientale dhe historike;
- f) që objekti i ndërtuar - vendosur, të bëhet sipas tërësisë së kompleksit arkitektonik;
- g) që ndërtimi - vendosja e objektit, të bëhet në distancën nga rrugët e kategorizuara, të parapara me rregullativën ligjore mbi rrugët publike;
- h) që objekti i ndërtuar-vendosur, të mos pengojë shfrytëzimin normal të objekteve të përherëshme.

## **Neni 12**

12.1 Ndalohet transferimi i objektit nga një lokacion në tjetrin, bartja e së drejtës për shfrytëzimit përmes ndërrimit, faljes apo shitjes, si dhe aneksndërtimi, me qëllim të zgjerimit të objektit ekzistues.

12.2 Ndërrimi i ushtrimit të veprimtarisë mund të bëhet vetëm me leje përkatëse të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit të Komunës së Prishtinës.

## **Neni 13**

13.1 Leja për vendosje në tokën e dhënë për shfrytëzim, jepet në shfrytëzim në afat prej 1 viti.

13.2 Afati nga pika 1 e këtij neni, mund të vazhdohet me vendim të veçantë deri në 5 vjet.

13.3 Vazhdimi i afatit nga pika 2 e këtij neni, lidhet ngushtë me realizimin e planit urbanistik për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm.

## **Neni 14**

Për vendosjen e objekteve nga neni 2, pika 3 e kësaj Rregulloreje, prona jepet në shfrytëzim të përkohshëm me dhënie të drejtpërdrejtë sipas kërkesës së palëve të interesuara, për numër të caktuar të ditëve, më së shumti deri në 6 muaj.

### **Neni 15**

Komuna mund të tërheqë vendimin edhe para kalimit të afatit të caktuar me vendim për dhënien e tokës në shfrytëzim të përkohshëm, nëse:

- a) bëhet realizimi i planit rregullues brenda afatit të caktuar me vendimin për dhënien e tokës për shfrytëzim të përkohshëm;
- b) nuk shfrytëzohet nga personi, i cili e ka fituar të drejtën sipas konkursit;
- c) zhvillon punime, me qëllim të zgjerimit të objektit të përkohshëm të ndërtuar - vendosur;
- d) bën transferimin e objektit të vendosur nga lokacioni i caktuar;
- e) bën bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të tokës përmes shitjes apo ndërrimit;
- f) bën ndërrimin e destinimit të veprimtarisë pa leje përkatëse nga organi kompetent komunal;
- g) vërtetohet se objekti i ndërtuar - vendosur, pengon zhvillimin e trafikut të këmbësorëve, pengon shikueshmërinë në udhëkryqe apo prish estetikën e kompleksit arkitektonik.

### **Neni 16**

16.1 Anulimi i vendimit nga neni 24 i kësaj Rregulloreje, bëhet nga organi që ka marrë vendimin për dhënien e tokës në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm.

16.2 Anulimi i vendimit nga pika 1 e këtij neni, nënkupton edhe anulimin e lejes për ndërtimin-vendosjen e objektit të përkohshëm.

## **IV**

### **Kushtet urbanistiko-teknike**

#### **Neni 17**

Kushtet urbanistiko-teknike për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, caktohen nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

#### **Neni 18**

Objektet e përkohshme të ndërtuara - vendosura me destinim të shitjes së gjërave ushqimore, duhet të kenë edhe hapësirën për pajisjet sanitare, ndërsa ngrohja duhet të bëhet vetëm me mjetet e izoluara, ngrohëse elektrike.

#### **Neni 19**

Për ndërtimin e strehëve të udhëtarëve për pritjen e trafikut urban në territorin e qytetit të Prishtinës, si dhe për vendosjen e tabelave dhe panove reklamuese, përpos procedurës së paraparë me këtë Rregullore, është e domosdoshme edhe marrja e pëlqimit nga organi kompetent për çështje të trafikut, i cili jepet në pajtim me ligjet në fuqi.

## Neni 20

Rrethojat, si objekte të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, mund të ndërtohen nga rruga, kur këtë e lejojnë planet urbanistike. Rrethojat nga rruga vendosen në vijën rregulluese. Mënyra e ndërtimit, forma, materiali dhe ngjyra e rrethojave, duhet t'i përshtatet pamjes së rrugës dhe rrethinës, por lartësia e tyre nuk mund të jetë më e lartë se 150 cm, dhe në lartësinë mbi 60 cm nuk mund të jetë e plotë.

## Neni 21

Lartësia e objekteve nga neni 2, pikat 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, duhet të jetë në atë masë që mundëson punën normale në të. Varësisht nga lloji i objektit, lartësia, nga pika 1 e këtij neni, duhet të jetë nga 250 cm deri në 350 cm.

## Neni 22

Përveç kushteve të parapara në bazë të neneve: 17, 18, 19, 20 dhe 21 të kësaj Rregulloreje, kërkuesi duhet të paraqesë edhe këtë dokumentacion:

*a. Për vendosjen e kabinave (foltoreve) telefonike:*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- licencën nga MTI - ja,
- lejen e punës nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- skicën e lokacionit,
- atestin e qëndrueshmërisë (statika, tokëzimi) dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit.

*b. Për vendosjen e ekraneve elektronike reklamuese:*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- projektin e lokacionit me skicë,
- pëlqimin urbanistik,
- atestin teknik dhe elektronik,
- statikën dhe peshën e ekranit dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit të pronarit.

*c. Për vendosjen e gjeneratorëve statik:*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- pëlqimin nga organi kompetent i BL-këshilli,
- specifikat e gjeneratorit (lloji),
- atestin mbi mbrojtjen nga rreziqet (nga DSHMSH-së),

- atestin për mbrojtjen nga zhurma,
- skicën e lokacionit dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit.

*d. Për vendosjen e lojërave në hapësira publike:*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- skicën e lokacionit dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit.

*e. Për vendosjen e automjeteve speciale për shitjen e ushqimit të shpejtë:*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- konfirmimin nga Drejtoria e Inspektionit për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare,
- certifikatën për kualifikimin përkatës për ushtrimin e biznesit,
- skicën e lokacionit dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit.

*f. Për vendosjen e tendave të hapura – lëvizëse me mekanizëm, montuese (prill – shtator):*

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- skicën e lokacionit dhe
- fotokopjen e lejes së njoftimit të pronarit.

## V

### **Leja për vendosjen dhe ndërtimin e objekteve të përkohshme.**

#### **Neni 23**

23.1 Lejen për ndërtimin e objekteve të përkohshme, nga neni 2, pikat 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, e jep Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

23.2 Për objektet e përkohshme nga neni 2, pikat 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje, lejen për vendosjen e tyre e jep Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

23.3 Leja nga pika 2 e këtij neni, jepet drejtpërdrejt sipas kërkesës së palës, pa dhënien paraprake të pronës për shfrytëzim të përkohshëm, me kusht që paraprakisht të paguhet taksa sipas lartësisë së paraparë me tarifat përkatëse të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

23.4 Kërkesa për dhënien e lejes nga pika 3 e këtij neni, i parashtrohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

## **Neni 24**

24.1 Kërkesa për dhënien e lejes për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme nga neni 2, pika 1 dhe 2 e kësaj Rregulloreje, i parashtrohet Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

24.2 Bashkë me kërkesën për leje ndërtimi - vendosje të objektit të përkohshëm, kërkuesi duhet të paraqesë edhe këtë dokumentacion:

- a) vendimin për dhënien e pronës në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm;
- b) kopjen e planit me vizatimin e lokacionit dhe kushtet urbanistiko-teknike,
- c) dokumentacionin teknik, tri kopje, dhe
- d) pëlqimet dhe dëshmitë e tjera të përcaktuara me dispozitat e veçanta.

24.3 Afati i lejes për ndërtimin, përkatësisht vendosjen e objektit të përkohshëm, është drejtpërdrejt i lidhur me afatin e caktuar me vendimin për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin -vendosjen e objektit të përkohshëm.

## **Neni 25**

Për ndërtimin e objekteve të përkohshme, hartohet dokumentacioni teknik.

## **Neni 26**

Ndërtimi apo vendosja e objekteve të përkohshme me sipërfaqe më të vogël se 16 m<sup>2</sup>, bëhet sipas skicës dhe përshkrimit teknik. Skica e objektit nga kjo dispozitë, hartohet në përpjesë 1:25 ose 1:50 dhe përmban bazën dhe prerjen me masat dhe pasqyrën e objektit sipas gjendjes në terren. Përshkrimi teknik, përveç dimensioneve të objektit, përmban edhe përshkrimin e konstruksionit, konstruksionin e veçantë të kulmit, si dhe përshkrimin e materialit që do të përdoret gjatë ndërtimit. Nga përshkrimi teknik, organi kompetent komunal për punët e urbanizmit vlerëson plotësimin e kushteve urbanistiko - teknike të objektit që do të ndërtohet apo vendoset.

## **Neni 27**

Ndërtimi apo vendosja e objekteve të përkohshme me sipërfaqes mbi 16 m<sup>2</sup>, bëhet sipas dokumentacionit teknik. Dokumentacioni teknik për ndërtimin e objekteve nga pika 1 e këtij neni, përmban projektin kryesor (planin e situatës me objektin e vizatuar dhe objektet fqinje, përshkrimin teknik të objektit, llogarinë statike të instalimeve), si dhe paramasat dhe parallogaritë e punëve.

## **Neni 28**

Dokumentacioni teknik për ndërtimin e objekteve të përkohshme, në kuptim të kësaj Rregulloreje, hartohet sipas lejes urbanistike të dhënë nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.



### **Neni 29**

Dokumentacionin teknik, si dhe skica dhe përshkrimi teknik, duhet të hartohet nga organizata biznesore (personi fizik, personi juridik apo organizata tjetër, i/e autorizuar dhe i regjistruar për hartimin e dokumentacionit teknik).

### **Neni 30**

Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit jep pëlqimin në dokumentacionin teknik, si dhe në skicën dhe përshkrimin teknik lidhur me atë se ky dokumentacion është hartuar në pajtim me kushtet urbanistiko - teknike. Nëse dokumentacioni teknik, në kuptim të kësaj Rregulloreje, nuk është hartuar në pajtim me kushtet e caktuara urbanistiko - teknike, organi nga paragrafi 1 i këtij neni, do të refuzojë dhënien e pëlqimit në dokumentacionin teknik.

### **Neni 31**

Për ndërtimin apo vendosjen e objekteve nga neni 35 i kësaj Rregulloreje, bashkëngjitet dokumentacioni teknik, në tri kopje, (projekti kryesor).

### **Neni 32**

Lejen urbanistike për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme, në kuptim të kësaj Rregulloreje, e jep Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

### **Neni 33**

Investuesi i objektit të përkohshëm ka për obligim të informojë organin e Administratës që ka dhënë lejen për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm, 8 ditë para fillimit të ndërtimit - vendosjes së objektit.

### **Neni 34**

Mbikëqyrjen e zhvillimit të punimeve ndërtimore, përkatësisht vendosjen e objektit të përkohshëm në kuptim të kësaj Rregulloreje, e bën organi kompetent komunal për punët e inspektoratit të ndërtimtarisë. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni, në bazë të kontrollit, vërteton ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme sipas dokumentacionit teknik.

### **Neni 35**

Leja për vendosjen - ndërtimin e objektit të përkohshëm pushon të vlejë, nëse objekti nuk vendoset - ndërtohet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e lëshimit të lejes, përkatësisht nga dita e pranimit të lejes nga pala.

## **VI**

### **Leja për përdorim**

### **Neni 36**

36.1 Pas ndërtimit të objektit të përkohshëm, investuesi është i obliguar të marrë lejen për përdorim. Pas përfundimit të ndërtimit, investuesi ka për detyrë t'i paraqesë edhe punët tjera dhe të bëjë kërkesën për marrjen e lejes për përdorim më së largu 15 ditë pas kryerjes së punëve. Leja për përdorim e objektit mund të jepet pas shikimit teknik të objektit, për të vërtetuar përshtatshmërinë e tij për përdorim.

36.2 Objekti është i përshtatshëm për përdorim, nëse:

- a) mund të përdoret për destinimin e paraparë;
- b) nuk rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- c) nuk rrezikon dhe nuk pengon shfrytëzimin e objekteve në afërsi;
- d) janë plotësuar kushtet për sigurimin nga zjarri, mospengimin e trafikut, si dhe kushtet për mbrojtjen në punë;
- e) objekti është ndërtuar sipas dokumentacionit, në bazë të të cilit është lëshuar leja dhe
- f) janë plotësuar kushtet e veçanta, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit.

### **Neni 37**

Shikimin teknik e bën Komisioni për shikim teknik të objekteve, me kërkesën e investuesit. Për shikimin e bërë teknik hartohet procesverbali. Në procesverbal shënohet lënda e shikimit teknik, cili dhe çfarë dokumentacioni i është ofruar komisionit, mendimin dhe propozimin e komisionit. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e Komisionit.

### **Neni 38**

38.1 Organi i Administratës, i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, ka për detyrë ta japë lejen për përdorim brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së mendimit nga komisioni, se objekti është i përshtatshëm për përdorim.

38.2 Organi nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të refuzojë dhënien e lejes për përdorim, nëse investuesi nuk i ka plotësuar kushtet që janë caktuar në lejen për ndërtim.

### **Neni 39**

Nëse gjatë shikimit teknik vërtetohet se lëshimet në objektin e ndërtuar nuk mund të mënjahen dhe, për shkak të atyre lëshimeve ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, organi që e ka dhënë lejen për ndërtim merr vendimin për rrënimin e objektit, përkatësisht largimin e objektit. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ndalon zbatimin e vendimit.

### **Neni 40**

Ankesat kundër vendimit të marr në bazë të nenit 39, mund t'i paraqiten kryesit të punëve.

## VII

### Largimi (heqja) e objektit të përkohshëm

#### Neni 41

Leja për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm, mund të anulohet edhe para kalimit të afatit të caktuar, nëse:

- a) paraqitet nevoja për realizimin e planit urbanistik, të programit të rregullimit, apo për shkak të pengimit të trafikut të këmbësorëve;
- b) ka kaluar afati i caktuar për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore, apo është bërë tërheqja e vendimit sipas nenit 24 të kësaj Rregulloreje;
- c) nuk paguhet kompensimi për shfrytëzimin e tokës ndërtimore brenda afateve të caktuara me rregullativën ligjore përkatëse;
- d) objekti tjetërsohet te personi i tretë, në bazë të faljes, shitjes, ndërrimit apo dhënies me qira.

#### Neni 42

Anulimi i lejes nga neni 41 i kësaj Rregulloreje, bëhet me vendim të veçantë. Vendimin për anulimin e lejes e merr organi i cili e ka dhënë lejen. Me vendimin

nga paragrafi 2 i këtij neni, caktohet afati për largimin e objektit. Afati nga paragrafi 3 i këtij neni, është 8 ditë nga dita e pranimit të vendimit mbi anulimin e lejes. Nëse objekti nuk largohet brenda afatit të caktuar me vendimin për largimin e objektit të përkohshëm, largimin e objektit e bën organi kompetent komunal, me detyrim që shpenzimet për largimin e objektit t'i mbulojë poseduesi i lejes së ndërtimit-vendosjes së objektit.

#### Neni 43

Ankesa kundër vendimit të nxjerrë në bazë të neneve 15 dhe 42 të kësaj Rregulloreje, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit për largimin e objektit të përkohshëm.

#### Neni 44

Çdo ndërtim - vendosje e objekteve të përkohshme në tokën ndërtimore, në të cilën Komuna e ka të drejtën e administrimit, në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, do të trajtohet e kundërligjshme.

#### Neni 45

Për largimin e objektit të përkohshëm, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, pronari i objektit të përkohshëm nuk gëzon kurrfarë të drejte në kompensim material, e as të drejtën në caktim tjetër të lokacionit.

## VIII

### Mbikëqyrja dhe masat administrative

#### Neni 46

Mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, e bën organi kompetent komunal, Inspektorati i ndërtimtarisë. Pronarët e objekteve të përkohshme janë të obliguar t'i mundësojnë organit nga pika 1 e këtij neni, kontrollimin e dokumentacionit teknik dhe dokumentacionit tjetër për ndërtimin - vendosjen e objektit të përkohshëm.

Me kryerjen e mbikëqyrjes, Inspekcioni i ndërtimtarisë, me vendim të veçantë, urdhëron:

- a) eliminimin e lëshimeve të konstatuara gjatë ndërtimit-vendosjes së objektit;
- b) ndalimin e përdorimit të objektit dhe të pajisjeve deri sa të mos mënjanojnë lëshimet e vërtetuara;
- c) ndalimin e ndërtimit - vendosjes së objektit pa leje ndërtimi.

Organi kompetent për inspektimin e ndërtimeve, cakton me vendim afatin për eliminimin e të metave të konstatuara.

#### Neni 47

Organi kompetent për inspektimin e ndërtimeve, urdhëron me vendim heqjen apo rrënimin e objektit pa kompensim (në shpenzimet e pronarit të objektit), nëse:

- a) objekti është ndërtuar - vendosur pa leje;
- b) objekti nuk është ndërtuar-vendosur sipas lejes së dhënë urbanistike;
- c) nuk vepron sipas vendimit për eliminimin e konstatimeve të inspektoratit të ndërtimit brenda afateve të caktuara.

Me vendimin për heqjen e objektit, do të caktohet afati për heqje, do të konstatohet se heqja e objektit bëhet me shpenzimet e pronarit të objektit të përkohshëm dhe do të kërkohet kthimi i tokës ndërtimore në gjendjen e mëparshme.

## IX

### Dispozitat ndëshkimore

#### Neni 48

Personi fizik dhe personi juridik do të gjobitet me gjobë prej 450 € deri 750 €, nëse:

- a) ndërton - vendos objektin pa lejen e organit komunal, kompetent për punë të urbanizmit;

- b) objekti është ndërtuar - vendosur në kundërshtim me lejen urbanistike, sipas së cilës është dhënë leja për ndërtim - vendosje, vendosjen e objektit dhe
- c) nëse nuk vepron në bazë të vërejtjeve të dhëna me vendimin e organit komunal për punë të inspektimit të ndërtimtarisë.

Për kundërvajtjet e shkaktuara nga personi juridik, sipas kësaj dispozite, përpos personit përgjegjës, do të gjobitet edhe personi juridik me gjobë prej 1000 €.

**X**

## **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

### **Neni 49**

Pronarët e objekteve të përkohshme të ndërtuara - vendosura sipas lejeve

paraprake, para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, duhet të paraqiten pranë organeve kompetente komunale për harmonizimin e dokumentacionit sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje. Kërkesa nga pika 1 e këtij neni, duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 50**

Për çdo çështje që nuk është rregulluar me dispozitat e kësaj Rregulloreje, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

### **Neni 51**

Ditën e miratimit të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për ndërtimin - vendosjen e objekteve në sipërfaqe publike, 01 nr. 010-2, të dt. 3.1.2002 dhe Vendimi për ndryshimin e plotësimit të Rregullores për ndërtimin - vendosjen e objekteve në sipërfaqe publike, 01 nr. 031 - 13925, të dt. 14.6.2005.

### **Neni 52**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

## **KUVEDNI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01.nr. 110-1936, më 28.7.2010**

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

**Sami Hamiti, ecc.i dipl.**